

UKR Shkodër



Shkodër Fushë-
Arrëz Matësi e
Madhe Pukë
Vau Dejës

Investimet e WPIP/MIP V me vlerë 19.5 milionë euro



KFW



Co-funded by
the European Union



Furnizimi me ujë të pijshëm

- Rehabilitimi dhe zëvendësimi i **53.7 km rrjet shpërndarës** të amortizuar, me humbje të larta uji dhe me një numër të konsiderueshëm lidhjesh të paligjshme.
- **1,820 lidhje të reja familjare** dhe instalimi i 2,500 matësve individualë të ujit.
- Përmirësimi i presionit të furnizimit përmes ndërtimit të rreth **4 km tubacion të ri kryesor transmetimi**.
- Instalimi i **Zonave të Matjes së Distriktit (DMA)** për monitorimin dhe kontrollin e hyrjeve dhe humbjeve të ujit.

Sistemi i ujërave të zeza

- Përmirësimi i **Stacionit Kryesor të Pompimit të Shkodrës (MPS)**
- Ndërtimi i **Implantit të Trajtimit të Ujërave të Ndotura (ITUZ)** Shkodër me kapacitet prej rreth 82,500 PE (Ekuivalentë Banorësh).
- Ndërtimi i një **tubacioni të ri të ujërave të zeza me gjatësi 5 km**, nga Stacioni Kryesor i Pompimit deri te ITUZ-i, me kalim mbi lumin Buna.

Rrjetet e reja të furnizimit me ujë do të reduktojnë humbjet në rrjet dhe do të mundësojnë furnizim më të qëndrueshëm me ujë 24/7. Përmirësimi i sistemit të kanalizimeve dhe ndërtimi i implantit të ri të trajtimit të ujërave të ndotura do të kontribuojnë në mbrojtjen e mjedisit dhe në rritjen e cilësisë së jetës për qytetarët.

Të dashur qytetarë dhe klientë,

Ashtu si shumë qytete të Shqipërisë, Shkodra ka trashëguar një infrastrukturë të vjetëruar dhe të degraduar të ujësjellësit dhe kanalizimeve. Investimet e programit WPIP/MIP V përfaqësojnë një hap të rëndësishëm për modernizimin e sistemit. Këto investime shoqërohen edhe me mbështetje administrative dhe menaxheriale për të siguruar funksionim dhe qëndrueshmëri afatgjatë.

Si pjesë e programit të reformave të iniciuar nga Qeveria Shqiptare dhe AKUK, programi WPIP/MIP V po mbështet Ujësjellës Kanalizime Rajoni Shkodër në prezantimin e metodave, teknikave dhe mjeteve të reja. Qëllimi i kësaj mbështetjeje **është rritja e efikasitetit dhe cilësisë së shërbimeve në përputhje me standardet e BE-së.**

Ne rrisim efikasitetin, cilësinë e shërbimeve dhe transparencën



Fluksi i punës dixhitale i bazuar në GIS



Të dhënat dhe raportet mbi riparimet dhe inspektimet dërgohen në kohë reale në Sistemin e Informacionit të Menaxhimit.



Ndërtimi i kapaciteteve



Stafi ynë trajnohet rregullisht në metodat më të avancuara të punës.



Investim



Infrastruktura dhe pajisjet e reja reduktojnë humbjet e ujit dhe konsumin e energjisë – dy faktorët kryesorë të kostonë së shërbimit.



Monitorimi



Matësit individualë të ujit dhe matësit e instaluar në tubacionet kryesore mundësojnë identifikimin sistematik të rrjedhjeve të ujit.

Përdorni ujin me përgjegjësi në banjë, kuzhinë dhe kopsht



Eliminoni rrjedhjet nga rubinetat dhe depozitat e tualetëve për të shmangur humbjet e panevojshme të ujit.



Përdoreni ujin në mënyrë efikase duke mbyllur rubinetin gjatë larjes së dhëmbëve dhe sapunosjes së enëve.



Mblidhni dhe përdorni ujin e shiut për ujitjen e kopshtit tuaj.



Përgjegjësia jonë e përbashkët e bën sistemin teknikisht dhe financiarisht të qëndrueshëm



Ju kontribuoni me pagesën e rregullt të faturës mujore dhe me përdorimin e përgjegjshëm të ujit.



Ne ju shërbejmë me njohuritë tona profesionale dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë.



Facebook UKR Shkodër



Besmir Lesha


Director UKR Shkodër

Elidjana Çelaj

Director AKUK

WPIP/MIP V – Investime me vlerë 145.7 milionë euro për 6 shoqëri rajonale të ujësjellës-kanalizimeve

Bashkëpunimi Financiar Gjerman 'përmes KfW	Kredi	80 milionë euro
Qeveria Gjermane	Grant	9 milionë euro
Bashkimi European (IPA)	Grant	43.4 milionë euro
SECO	Grant	13.3 milionë euro



UKR Berat, përfshirë Dimalin, Kuçovën, Poliçanin dhe Skraparin

UKR Elbasan, përfshirë Belshin, Cërrikun, Gramshin, Librazhdin dhe Peqinin

UKR Fier, përfshirë Mallakastrën, Patosin dhe Roskovecin

UKR Lezhë, përfshirë Kurbinin dhe Mirditën

UKR Shkodër, përfshirë Fushë-Arrëzin, Malësinë e Madhe, Pukën dhe Vau i Dejës

UKR Vlorë, përfshirë Himarën dhe Selenicën



www.wpip-mipv.al

Masat shoqëruese të zbatuara nga:

Konsulenti i Implementimit për Shkodrën